



YOUTH ASSOCIATION FOR HUMAN RIGHTS
ASOCIACIONI RINOR PËR DREJTAT E NJERIUT



Raport monitorues XII-të

**mbi punën e legjislativit të komunës së
Lipjanit**

Nëntor 2015

Përmbajtja:

- Hyrje,
- Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit,
- Përmbledhje ekzekutive,
- Dinamika e punës së Kuvendit,
- NOTIMI,
- TRENDI I DISKUTIMEVE,
- ÇËSHTJET E INICIUARA,
- PYETJET E PARLAMENTARE,

Adresa: Rr."Dr. Avdi Avdiu" 14000 Lipjan
Tel.+377 (0) 44 786 414 & +386 (0)49 823 140
e-mail: info.yahr@gmail.com
ueb faqja: <http://www.ngoyahr.weebly.com>
<http://www.yahr-monitorimi.weebly.com>

"Ky projekt u financua përmes grantit të Olof Palme International Center. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Olof Palme International"



Hyrje


Organizata Joqeveritare YAHR- do të vazhdojë me monitorimin e aktiviteteve të legjislativit dhe të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit ,gjatë periudhës katër vjeçare 2013/2017 dhe do të dal me raporte monitoruese- vlerësuese për çdo gjashtë muaj.

Youth Association for Human Rights /YAHR që nga vitit 2009 është duke bërë monitorimin pro aktiv të punës së kuvendit të Komunës së Lipjanit. Në monitorimin e punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për periudhën gjashtë mujore, nëpërmes këtij raporti YAHR provon të kontribuoj në ofrimin e informacioneve të strukturuar të cilat do të jenë në shfrytëzim, para së gjithash për qytetarin e Komunës së Lipjanit, shoqërinë civile, mediat, si dhe vetë institucionin e monitoruar, Kuvendin e Komunës së Lipjanit. Në këtë drejtim, në formë të renditur nëpërmes këtij raporti ofrojmë të dhëna të cilat pasqyrojnë disa aspekte të punës së Kuvendit. YAHR nëpërmjet monitorimit pro aktiv dhe por edhe në bashkëpunim me institucionin e Kuvendit si dhe palë të përfshira në këtë proces, YAHR ka arritur t'i siguroj këto informacione, të cilat do të mund të zhvilloheshin edhe më tej, në rast të një bashkëpunimi më cilësor nga ana e institucioneve, apo edhe në rast të organizimit dhe funksionimit të tyre më të mirëfilltë. Nëpërmes aktiviteteve monitoruese YAHR është përfshirë në këto drejtime si puna në seanca plenare dhe puna në Komitetet.

Në hartimin e këtij raporti të dymbëdhjetë monitorues për punën e legjislativit të Kuvendit komunal të Lipjanit, YAHR është mbështetur në shumë burime të informacionit: monitorimin e mbledhjeve të bordit të drejtorëve, monitorimi i seancave të Kuvendeve Komunale, Komiteteve për Politikë dhe Financa, analizimit të dokumenteve të ndryshme si procesverbale dhe rendet e ditës, analizimi i raporteve të medieve të shkruara dhe elektronike, debatet si dhe diskutimet e organizuara nga shoqëria civile.

Bekim Krasniqi

Drejtör ekzekutiv i YAHR-it



Qëllimet e monitorimi të punës së Kuvendi të Komunës së Lipjanit

YAHR në tentativë për të adresuar interesat dhe brengat të qytetarëve në mënyrë të paanshme dhe apartiake u ofron qytetarëve informata në mënyrë të vazhdueshme. Synimi i monitorimit të punës së zyrtarëve të zgjedhur është ndërtimi i një shoqërie të qëndrueshme demokratike.

Qëllimet e monitorimi të punës së zyrtarëve komunal janë:

- Që të sigurohet kredibiliteti i proceseve politike;
- Që të sigurohet përgjegjshmëria e zyrtarëve të zgjedhur ndaj qytetarëve dhe që ata të jenë përfaqësues të vërtetë të interesave të shoqërisë;
- Që të sigurohet transparenca në punën e zyrtarëve të zgjedhur;
- Që të sigurohet pjesëmarrja e qytetarëve në proceset politike vendore;
- Që të parandalohen parregullsitë e mundshme, aktivitetet mashtruese dhe kërcënimet;
- Që të inkurajohen zyrtarët e zgjedhur në punën e tyre për gjetjen e zgjidhjeve që rëndojnë shoqërinë civile;
- Që zyrtarëve të zgjedhur t’iu ofrohen informata mbi brengat e vërteta me të cilat ballafaqohet shoqëria civile;
- Që të informohen qytetarët se si zyrtarët e zgjedhur trajtojnë brengat e tyre si bazë për çfarëdo veprimi qytetar drejt zgjidhjes së atyre brengave.

Përmbledhje ekzekutive

Youth Association for Human Rights (YAHR) publikon raportin e monitorimit “Qeverisja Lokale në Lipjan” bazuar në monitorimin e punës së Kuvendit komunal të Komunës së Lipjan gjatë periudhës Qershor-Nëntor 2015. Monitorimi është fokusuar në Asamblenë Komunale dhe organet tjera të këtij Kuvendi.

Në bazë të punës sonë monitoruese të drejtpërdrejtë dhe në bazë të vlerësimeve me anë të fletë notimit kemi konstatuar këto fakte:

- ✓ Në periudhën e dytë e këtij viti 2015, Kuvendi Komunal i Lipjanit karakterizohet me përplasje të ashpër në mes opozitës dhe pozitës. Kjo ashpërsi e komunikimit në mes opozitës dhe pozitës e arrin kulminacionin në seancën e fundit, ku për pak nuk eskalon edhe në konflikt verbal në mes deputeteve të dyja blloqeve. Gjatë kësaj periudhe opozita e përfaqësuar nga PDK-ja karakterizohet me një angazhim konkretë në diskutimet në seanca, duke u munduar që argumente të dëshmoj dështimet e qeverisjes së pozitës gjatë këtij viti 2015.
- ✓ Sa i përket këtyre angazhimeve individuale të deputeteve me pyetjet parlamentare vazhdohet që të jenë aktiv. Ku gjatë kësaj periudhe kemi 2 pyetje drejtuar ekzekutivit dhe janë ngritur 17 çështje konkrete të problemeve që ballafaqohen qytetarët e Komunës së Lipjanit. Është interesante se të gjitha këto pyetje dhe shqetësime të deputetëve të Kuvendit Komunal të Lipjanit nuk marrin përgjigje adekuatë nga ana e ekzekutivit. Ekzekutivi i komunës është i obliguar që të ju përgjigjet deputetëve në rast të parashtrimit të pyetjeve, për mos përgjigje ndaj pyetjeve të parashtruara nga deputet kemi të bëjë me shkelje të ligjit për

vetëqeverisje lokale Nr. 03/L-040 të datës 20 shkurt 2008, të nenin 39. Ku ka të bëjë me të drejtat dhe detyrat e anëtarëve të kuvendit të komunës, pika 2, ku thuhet citojmë: "Anëtar i kuvendit të komunës ka të drejtë të kërkojë informacione lidhur me çështjet komunale nga kryetari, apo nga zëvendës-kryesuesi i komitetit. Kërkesa shqyrtohet në pajtim me procedurat që do të përcaktohen në Statut dhe Rregulloren e punës". Po ashtu, kemi shkeljen e rregullores së punës të Kuvendit Komunal të Lipjanit të datës 07.11.2014, të Kapitullit VI. Ku ka të bëjë me të drejtat, obligimet e anëtarëve të Kuvendit dhe parashtrimi i propozimeve procedurale, ku në nenin 14 lidhur me të drejtat e anëtarëve të Kuvendit të komunës në pikën "e", thuhet citojmë: "" Të kërkojnë nga Kryetari i Komunës dhe drejtorët e organeve të Administratës Komunale, informacione me gojë dhe me shkrim lidhur me çështjet komunale".

- ✓ Gjatë kësaj periudhe raportuese të gjitha komitetet e Kuvendit Komunal të Lipjanit, me përjashtim të KPF-së janë pasive dhe nuk kemi një punë konkrete të këtyre komiteteve dhe mbledhjet që mbahen janë shumë formale.

	Komitetet *informatat janë marrë nga ueb faqja e komunës: http://kk.rks-gov.net/lipjan/Njoftimet.aspx	Numri i mbledhjeve të mbajtura gjatë periudhës Janar-Nëntor 2015	Numri i mbledhjeve të mbajtura prej themelimit deri Nëntor 2015
1	Komiteti për Politikë dhe Financa	10	18
2	Komiteti për Komunitete	7	14
3	Komiteti për Planifikim dhe Urbanizëm	4	11
4	Komiteti për Bujqësi Pylltari dhe Zhvillim Rural	0	0
5	Komiteti për Shëndetësi	0	0
6	Komiteti për Arsimit	2	4
7	Komiteti për Shërbime Publike	2	2
8	Komiteti Konsultative	0	0

- ✓ Komuna e Lipjanit vazhdon me shkeljen e Ligjit për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008, me anë të Statutit Komunal (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008). Ku në bazë të këtij ligji, Komuna e Lipjanit i ka 59 vendbanime dhe fshatra, ndërsa në Statutin Komunal në kapitullin II, ku ka të bëjë me vendbanimet e komunës, gjegjësisht në nenin 13. rreth vendbanimet dhe fshatrat, figurojnë 70 vendbanime dhe fshatra, që do të thotë në bazë të ligjit të lartë përmendur Komuna e Lipjanit i ka 11 fshatra më pak se sa me statutin komunal.
- ✓ Top treshja me aktive nga ana e deputetëve të kësaj legjislature për periudhën Qershor- Nëntor 2014 është: **FLORENT HOXHA PDK 78 pikë, PETRIT KELMENDI PDK 41 pikë dhe BLERIM GASHI AKR 41 pikë.**

- ✓ Top 7-ta më pasive në Kuvendin Komunal për periudhën Janar-Qershor 2014 përbëhet nga deputetet: **VLORA BUJA PDK, ARTON RETKOCERI LDK, BURBUQE FAZLIU LDK, RIZAH BAJRAKTARI AAK-LDD-IQL, ADELINA KRASNIQI AKR, XHAVID MAHOLLI PD me 0 pikë dhe FERIZ HASANI PDK me -1 pikë,**
- ✓ Në legjislaturën e re 2013/2017, është për tu çuditur edhe pse nuk janë paguar në mënyrë të rregullt anëtarët e komiteteve si përfaqësues të organeve të Kuvendit komunal, është rritur numri i anëtareve në këto komitete nga 40 në 56 anëtar sa ka pasur në legjislativin e kaluar,
- ✓ Vazhdohet me mos transparencë nga ana e Kryesueses së Kuvendit Komunal, me injorimin e dërgimit të materialeve të seancave të Kuvendit ndaj shoqërisë civile.
- ✓ Po ashtu kemi konstatuar mos efikasitet të punëve të Komiteteve të formuara me përjashtim të komitetit për politikë dhe financa,

Rekomandimet:

- ✓ Ofrimin e përgjigjeve nga ana e ekzekutivit ndaj pyetjeve të parashtruar nga ana e deputeteve komunal,
- ✓ Harmonizimi i Statutit Komunal me (Nr. .110-623 i datës 26.09.2008) dhe ligjet aktuale në fuqi të Republikës së Kosovës, gjegjësisht me Ligjin për Kufijtë Administrativë të Komunave Nr. 03/L-041 të datës 20 shkurt 2008.
- ✓ Një opozitë me e zëshme për artikullimin e interesave të qytetareve karshi ekzekutivit të Komunës së Lipjanit,
- ✓ Dërgimin e materiale të Kuvendit për organizatat monitoruese,
- ✓ Delegatet e Kuvendi i Komunës së Lipjanit duhen të jenë më aktivë dhe më efikas , e sidomos nëpër komitete.

Dinamika e punës së Kuvendit

Në këtë vit 2015 deri me tani janë mbajtur dhjetë seanca plenare të rregullta, 10-të mbledhje të Komitetit për Politikë dhe financa. Krahasuar me vitin e kaluar është një gjendje e njëjtë.

Lista e raporteve të shqyrtuara nga Kuvendi komunal të vitit 2015:

- *Raporti i punës i Zyrës së Kryetarit dhe Drejtorive Komunale për vitin 2014,*
- *Raporti i Buxhetit të alokuar dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve, kategorive ekonomike dhe programeve si dhe planifikimi dhe realizimi i të hyrave vetanake për vitin 2014,*
- *Raporti i Buxhetit të Alokuar dhe Shpenzimi në Bazë të Burimit të Mjeteve të Kategorive Ekonomike dhe programeve për Tremujorin e vitit 2015 Për Komunën e Lipjanit,*
- *Raport i buxhetit të alokuar dhe shpenzimi në bazë të burimit të mjeteve kategorive ekonomike dhe programeve për 6 mujorin e vitit 2015 të Komunës së Lipjanit,*
- *Raporti nëntëmujor i shpenzimeve të buxhetit dhe të hyrat për vitin 2015*

Lista e rregulloreve dhe planeve komunale të miratuar gjatë vitit 2015:

- *Rregullore për Taksat Komunale.*
- *Rregullore për Ndarjen e Subvencioneve nga Buxheti i Komunës*
- *Rregullore për Plotësimin dhe Ndryshimin e Rregullores për Bashkëpunimin e Komunës dhe Organizimin e Fshatrave, Vendbanimeve dhe Lagjeve Urbane.*
- *Rregullore për detyrat e punës, obligimet, përgjegjësit dhe masat disiplinore të personelit të institucioneve edukativo-arsimore të Komunës së Lipjanit.*
- *Rregullore për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores për disiplinën dhe mirësjelljen në shkollat e Komunës së Lipjanit 1Nr.116-724 e datës 20. 07. 2010,*

Lista e vendimeve komunale të miratuar gjatë vitit 2015:

- *Vendim për rritjen e Buxhetit të Komunës së Lipjanit nga tejkalimi i të hyrave vetanake për vitin 2014.*
- *Vendim mbi dhënien e pëlqimit për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Lipjanit të vitit 2013 dhe 2014 në vitin 2015.*
- *Vendim për plotësimin e Vendimit paraparak për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronave të pakujtueshme të Komunës 15Nr.464-40375/2014,*
- *Vendim për plotësimin e Vendimit për dhënien në shfrytëzim të tokës pasuri shoqërore e KK Lipjan ,KBI (Këshillit të Bashkësisë Islame) për Xhaminë e Fshatit Gadime e Epërme 15Nr.464-40387/2014,*
- *Shqyrtimi i propozim Vendimit për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare BI në Lipjan*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen-transferimin e mjeteve financiare,*
- *Vendim i dytë për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan*
- *Vendim për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për Bashkëfinancim në Implementimin e Projektit – Rregullimi i Hapësirave Publike në Qytetin e Lipjanit.*
- *Vendim për Organizimin e Zgjedhjeve për Zgjedhjen e Këshillave Kryetarëve të Këshillave të Lokalitetit.*
- *Vendim mbi aprovimin e Kornizës afatmesme buxhetore 2016-2018,*
- *Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan.*
- *Vendimi për fillimin e iniciativës dhe veprimeve përgatitore për aplikim në MTI për marrjen e pëlqimit për themelimin e Zonës Ekonomike në Zonën Kadastrave Qylagë.*
- *Vendimi për caktimin e lokacionit për shkollën e mesme Gjimnazi “Ulpiana” në Lipjan,*
- *Vendim për caktimin e lokacionit për shkollën fillore e mesme e ulët “Emin Duraku” Banullë-Glllogovc,*

- *Vendim për dhënien në shfrytëzim të tokës pasuri-shoqërore e KK-së Lipjan, KB-is (Këshilli i Bashkësisë Islame) për ndërtimin e objektit për të pame për banorët e fshatit Kraishtë,*
- *Vendim për aprovimin e Buxhetit 2016-2018*
- *Vendim mbi miratimin e ri-destinimit dhe transferim të mjeteve buxhetore për vitin 2015*
- *Vendim për caktimin e tarifave për qëndrimin ditor të fëmijëve në Qendrën për Edukimin dhe Arsimimin Parashkollor në Lipjan*
- *Vendimi për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan,*
- *Vendim Paraprak për dhënien në shfrytëzim Afatshkurtër të pronave të paluajtshme,*
- *Vendim për miratimin e Planit Orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2016*
- *Vendim për miratimin e raportit të punës të Komisionit për çështje të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane të Komunës së Lipjanit,*
- *Vendim për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës të paluajtshme të Komunës,*
- *Vendim për anulimin e vendimit për ndarjen-transferimin e mjeteve financiare 15Nr.400-11527 i datës 03.03.2015*

NOTIMI I PËRGRHITHËM

Kuvendi i Komunës së Lipjanit numëron gjithsej 31 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 8 subjekte politike (LDK, PDK AAK-LDD-IQL, VETËVENDOSJE, AKR, PD ,PSD dhe G.I.SRPSKA).

Vlerësimet janë të bazuara në vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe objektiv të punimeve të kuvendit komunal të Lipjanit Monitoruesit e YAHR-it kanë përcjellë të gjitha seancat e kuvendit të komunës së Lipjanit gjatë periudhës Qershor - Nëntor 2015. Për më tepër, monitoruesit e YAHR-it kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të takimeve individuale me shumë anëtarë. Anëtarët komunalë dhe subjektet politike janë notuar veç e veç në secilën nga nëntë kategoritë e poshtëshënuara si dhe mbi performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).

KATEGORITË

YAHR-i në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike në kategoritë e paraqitura në vijim:

1. Propozim për rend dite
2. Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave
3. Pjesëmarrja në diskutime në emër të grupit të anëtarëve
4. Inicimi i çështjeve
5. Amandamentimi i legjislacionit
6. Inicimi i rregulloreve

7. Pyetjet parlamentare
8. Mungesa në seanca
9. Gjuha joparlamentare

Pjesëmarrja e delegateve të Kuvendit në diskutime nga seanca 20-22, në bazë të fletë-notimit për se cilin deputet:

- Vërejtje: përkatësia e politike e deputeteve është bazuar vetëm në bazë të certifikimit nga ana e KQZ-së dhe lëvizjet e bëra të deputeteve në mes subjekteve politike në këtë raport nuk janë marrë parasysh, se ka pasur lëvizje të shumta dhe nuk kemi qartësi të plotë të përkatësisë politike.

KOMUNA E LIPJANIT		Propozim për rend dite	Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve	Inicimi i çështjeve	Amandamentimi I legjislacionit	Inicimi I rregulloreve	Pyetjet parlamentare	Mungesa në seanca	Gjuha jo parlamentare	Gjithsej pike
Deputetët	Subjekti politik										
FLORENT HOXHA	PDK	0	56	2	20	0	0	0	0	0	78
PETRIT KELMENDI	PDK	0	36	0	5	0	0	0	0	0	41
RAGIP ZEJNULLAHU	PDK	0	8	0	0	0	0	0	-1	0	7
NAZMI KRASNIQI	PDK	2	32	0	0	0	0	0	-1	0	33
ENVER KOZHANI	PDK	0	12	0	5	0	0	0	0	0	17
FERIZ HASANI	PDK	0	0	0	0	0	0	0	-1	0	-1
ALI STUBLLA	PDK	0	28	0	5	0	0	0	0	0	33
VALBONA SHILLOVA	PDK	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
BURBUQE ILAZI	PDK	0	4	0	5	0	0	0	0	0	9
VLORA BUJA	PDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
LABINOT SHAHINI	LDK	0	4	3	0	0	0	0	0	0	7
NEHAT TERPEZA	LDK	0	0	2	5	0	0	0	0	0	7
DAUT AZEMI	LDK	0	4	1	0	0	0	0	0	0	5
AGRON HAJDINI	LDK	0	20	0	0	0	0	0	0	0	20
ARTON RETKOCERI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
NAIM JAHIRI	LDK	0	4	0	5	0	0	0	0	0	9
VLORA LIMANI-HAJNUNI	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
BURBUQE FAZLIU	LDK	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
LINDA SHAHINI	LDK	0	12	2	0	0	0	0	0	0	14
XHEVAT OLLURI	AAK-LDD-IQL	0	12	0	0	0	0	0	0	0	12

Youth Association for Human Rights

RIZAH BAJRAKTARI	AAK-LDD-IQL	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
UKË KRYEZIU	AAK-LDD-IQL	0	4	0	0	0	0	0	0	0	4
MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI	AAK-LDD-IQL	0	12	0	0	0	0	0	0	0	12
HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD-IQL	0	4	0	5	0	0	5	0	0	14
ARBEN BAHTIRI	VETËVENDOSJE	0	4	0	10	0	0	0	0	0	14
EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	2	20	0	0	0	0	0	0	0	22
BLERIM GASHI	AKR	0	36	1	0	0	0	5	-1	0	41
ALBULENA GASHI/ ADELINA KRASNIQI	AKR	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
XHAVID MAHOLLI	PD	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
RAMIZ QIRIQI	PSD	0	16	0	10	0	0	0	0	0	26
ZORAN CIRKOVIC	G.I.SRPSKA	0	0	0	10	0	0	0	0	0	10

Deputet aktivë dhe pasivë, me numrin e diskutimeve

	Deputeti	Subjekti politikë	pikët		Deputeti	Subjekti politikë	pikët
1	FLORENT HOXHA	PDK	78	16	BURBUQE ILAZI	PDK	9
2	PETRIT KELMENDI	PDK	41	17	NAIM JAHIRI	LDK	9
3	BLERIM GASHI	AKR	41	18	RAGIP ZEJNULLAHU	PDK	7
4	NAZMI KRASNIQI	PDK	33	19	LABINOT SHAHINI	LDK	7
5	ALI STUBLLA	PDK	33	20	NEHAT TERPEZA	LDK	7
6	RAMIZ QIRIQI	PSD	26	21	DAUT AZEMI	LDK	5
7	EDITA GASHI	VETËVENDOSJE	22	22	VALBONA SHILLOVA	PDK	4
8	AGRON HAJDINI	LDK	20	23	UKË KRYEZIU	AAK-LDD-IQL	4
9	ENVER KOZHANI	PDK	17	24	VLORA BUJA	PDK	0
10	LINDA SHAHINI	LDK	14	25	ARTON RETKOCERI	LDK	0
11	HAJRIJE SALIHU	AAK-LDD-IQL	14	26	BURBUQE FAZLIU	LDK	0
12	ARBEN BAHTIRI	VETËVENDOSJE	14	27	RIZAH BAJRAKTARI	AAK-LDD-IQL	0
13	XHEVAT OLLURI	AAK-LDD-IQL	12	28	ADELINA KRASNIQI	AKR	0
14	MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI	AAK-LDD-IQL	12	29	XHAVID MAHOLLI	PDK	0
15	ZORAN CIRKOVIC	G.I.SRPSKA	10	30	FERIZ HASANI	PDK	-1

Pjesëmarrja e subjekteve politike të Kuvendit në diskutime nga seanca 20-22, në bazë të fletë-notimit:



Subjekti politik	Propozim për rend dite			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave			Pjesëmarrja në Diskutime në emër të grupit të anëtarëve			Inicimi i çështjeve			Pyetjet parlamentare			Mungesa në seanca		
	Piket	%																
PDK	1	50	%	45	54.22	%	2	18.1	%	8	47.06	%	0	0.00	%	3	75	%
LDK	0	0	%	11	13.25	%	8	72.7	%	2	11.76	%	0	0.00	%	0	0	%
AAK-LDD-IQL	0	0	%	8	9.64	%	0	0	%	1	5.88	%	1	50.00	%	0	0	%
VV	1	50	%	6	7.23	%	0	0	%	2	11.76	%	0	0.00	%	0	0	%
AKR	0	0	%	9	10.84	%	1	9.09	%	0	0.00	%	1	50.00	%	1	25	%
PD	0	0	%	0	0.00	%	0	0	%	0	0.00	%	0	0.00	%	0	0	%
PSD	0	0	%	4	4.82	%	0	0	%	2	11.76	%	0	0.00	%	0	0	%
G.I.SRPSKA	0	0	%	0	0	%	0	0	%	2	11.76	%	0	0.00	%	0	0	%

TRENDI I DISKUTIMEVE

Gjatë periudhës Qershor - Nëntor 2015, pjesëmarrja në diskutime e anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Lipjanit në lidhje me pikat e rendit të ditës është karakterizuar me një rritje krahasuar me vitet tjera.



Deputetet më aktivë të kësaj periudhe kanë qenë udhëheqësit e grupeve të partive politike në Kuvend: FLORENT HOXHA PDK 78 pikë, PETRIT KELMENDI PDK 41 pikë, BLERIM GASHI AKR 41 pikë, NAZMI KRASNIQI PDK 33 pikë, ALI STUBLLA PDK 33 pikë, RAMIZ QIRIQI PSD 26 pikë, EDITA GASHI VETËVENDOSJE 22 pikë, AGRON HAJDINI LDK 20 pikë, ENVER KOZHANI PDK 17 pikë, LINDA SHAHINI LDK 14 pikë, HAJRIJE SALIHU AAK-LDD-IQL 14 pikë, ARBEN BAHTIRI VETËVENDOSJE 14 pikë, XHEVAT OLLURI AAK-LDD-IQL 12 pikë, MERITA ZEQRIRI-HAJRIZI AAK-LDD-IQL 12 pikë, ZORAN CIRKOVIC G.I.SRPSKA 10 pikë, BURBUQE ILAZI PDK 9 pikë, NAIM JAHIRI LDK 9 pikë, RAGIP ZEJNULLAHU PDK 7 pikë, LABINOT SHAHINI LDK 7 pikë, NEHAT TERPEZA LDK 7 pikë, DAUT AZEMI LDK 5 pikë, VALBONA SHILLOVA PDK 4 pikë, UKË KRYEZIU AAK-LDD-IQL 4 pikë,

Deputete më pasivë të ashtuquajtur "Shikues" janë: VLORA BUJA PDK 0 pikë, ARTON RETKOCERI LDK 0 pikë, BURBUQE FAZLIU LDK 0 pikë, RIZAH BAJRAKTARI AAK-LDD-IQL 0 pikë, ALBULENA GASHI/ ADELINA KRASNIQI AKR 0 pikë, XHAVID MAHOLLI PDK 0 pikë, FERIZ HASANI PDK -1 pikë,



PYETJET E PARLAMENTARE DHE INICIMI I ÇËSHTJEVE

Anëtarët e Kuvendit të Komunës së Lipjanit gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Qershor-Nëntor 2015, kemi vërejtur një trendë i rritjeve të pyetjeve dhe shqetësimeve drejtuar ekzekutivit të komunës së Lipjanit dhe kanë qenë për këtë periudhë gjithsej 2 pyetje dhe 17 çështje të ngritura. Subjekti i PDK-së gjatë kësaj periudhe i ka ngritur 8 çështje me 47.06 %, LDK 2 me 11.76 %, VV 2 me 11.76 %, PSD 2 me 11.76 %, G.I.SRPSKA 2 ose me 11.76%. dhe AAK-LDD-IQL 1 me 5.88 %.



Pyetjet e ngritura nga mbledhja e 19-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 29.06. 2015:

Ali Stublla: Kërkoji më shumë sqarime lidhur me zgjedhjet nëpër fshatra ,

Nazmi Krasniqi: Ngriti çështjen e kontejnerët nëntokësor që nuk janë funksional dhe se është premtuar se së shpejti do të funksionalizohen dhe ngriti çështjen e mos funksionimit të ndriçimit në disa rrugë të qytetit.

Agron Hajdini: ngriti një shqetësim të qytetarëve, ku në mes të objektit Urban Center dhe Marigonës është hap një gropë dhe është rrezik për qytetarët dhe kanë kërkuar që të mbyllet apo të rrethohet ajo gropë.

Enver Kozhani: në Ribarë të Madh janë duke u bërë matjet për asfaltimin e disa rrugëve por te lagja Rama, kjo rrugë është lënë anash dhe para dy muajve Kryetari ka deklaruar se nuk do të shtrojë rrugë të vëllezërve e kjo po ndodh. Unë kam biseduar me Drejtorin e Shërbimeve Publike dhe tenderi ende nuk është shpall për këtë rrugë dhe kërkoj që edhe rruga e lagjes Rama të përfshihet meqë ata janë anashkaluar edhe për kanalizim.

Po ashtu, ngriti edhe problemin në fshatin Kraishtë, ku banorët kanë shqetësim për shkak të mbylljes së kanalizimit ku ujërat e zeza kanë dalë mbi sipërfaqen e tokësore dhe kërkojnë që të rregullohet kanalizimi meqë është i pa përballueshëm kundërmimi dhe është rrezik për ndonjë epidemi.

Ramiz Qeriqi: shprehu shqetësimin e prindërve për semi-maturantët, meqë është fol se nuk do të ketë mbrëmje të maturës, por në Lipjan është organizuar mbrëmja e maturës dhe nxënësit kanë paguar, kurse mbrëmja nuk është mbajtur e nuk e di se a është fajtor Drejtori apo dikush tjetër për këtë çështje. E dyta te provimi i maturës për nxënësit ka qenë një lojë meqë provimi kishte qenë i varur prej arsimtarit që ka qenë në klasë meqë në disa klasë ua kanë marrë edhe telefonat a në disa klasë tjera u kanë thënë vetëm mos bëni zhurmë dhe kopjoni sa të mundni.

Merita Zeqiri-Hajrizi: Ngriti problemin dhe shqetësimin, ku theksoi se: “është e vërtetë që në një takim me arsimtar Kryetari i Komunës ka thënë se nuk ka mbrëmje të maturës për semi-maturant por mund të organizohet një koktej-ceremoni me pëlqimin e prindërve të nxënësve. Në shkollën tonë “Ismajl Luma” është organizuar koktej dhe marrëveshja ka qenë prej orës 16 por për shkak të vapës së madhe në sallën e shkollës, këtë koktej e kemi shty për në ora 18 dhe Drejtori i shkollës e ka ftuar Drejtorin e DKA-së për ta njoftuar për këtë, por nuk e ka hapur telefoni për shkak se kishte qenë i nxanun, kështu që ne koketin e kemi filluar në ora 18-të, ndërsa në ora 20 ka intervenuar policia për ndërprerjen e këtij kokteji dhe falë nxënësve nuk ka ndodh asnjë eksese, por nxënësit nuk janë ndarë të kënaqur dhe ne nuk e dimë, se kush ka intervenuar te policia”.

Pyetjet e ngritura nga mbledhja e 21-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 22.09. 2015:

Florent Hoxha: Kërkoj nga Drejtoria i Shërbimeve Publike që në rrugën “Qamil Olluri” të mbyllet një gropë por kjo nuk është bërë, andaj kërkojmë që kjo gropë që po rrezikon qytetarët të mbyllet më parë. Po ashtu, kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të paraqitet një informatë për gjendjen në arsim, në të kundërtën na do të detyrohemi të thërrasim mbledhje të jashtëzakonshme.

Blerim Gashi: Ngriti çështjen e objektit të ri të gjimnazit: “ para fillimit të vitit të ri shkollorë ishte një informatë se me 1 shtator do të fillon punën objekti i ri i gjimnazit, mirëpo kaluan edhe një muaj dhe mësimi nuk ka filluar në këtë objekt, andaj pyes Drejtorin se kur do të filloj punën ky objekt”.

Ramiz Qeriqi: Kërkoj që në mbledhjen e ardhshme në rend të ditës të hynë ndarja e banesave në pronësi të Komunës sepse njerëzit kanë nevoja të mëdha. Kërkesë tjetër kishte nga fshati Rubovc dhe Kojškë meqë transportuesi që bartë nxënësit me autobus nuk i plotëson kushtet teknike andaj kërkesa është që të shtohet edhe një autobus. Te fshati Resinovc në udhëkryqin e rrugës Cërnavë - Komoran të vihet një pasqyrë nëse ka mundësi Komuna. Në fund tha se nxënësit që nuk kanë libra mos të largohen nga mësimi nga arsimtarët.

Hajrije Salihu: Ngriti shqetësimin rreth fillimit të punës në objektin e ri të gjimnazit e gjithashtu kërkoj që në mbledhjen e ardhshme të paraqitet një informatë për çështjen e arsimit.

Enver Kozhani: kërkoj që në qendrën kryesore QKMF-së që laboratorit të furnizohet me material meqë në mungesë të materialeve , qytetarët janë orientuar që të shkojnë në laboratorët private.

Ali Stublla: kërkoj që për fshatin Topliqan, që komuna të shqyrton mundësinë për zgjerimin e varrezave meqë në varrezat ekzistuese nuk ka vend të mjaftueshëm.

Pyetjet e ngritura nga mbledhja e 22-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur më 27.10. 2015:

Florent Hoxha: ngriti çështjen e qytetarëve të Gadimes të cilët i janë drejtuar me shkrim Drejtorit për Shërbime Publike, për shtruarje e rrugës së Lumit në Gadime, e cila ka qenë e paraparë me buxhet, e që e njëjta pa paralajmërim është hequr nga buxheti. Pastaj kjo rrugë gjatë rregullimit të kanalizimit është dëmtuar shumë.

Shqetësim tjetër e ngriti rreth rrugës te “Abea “ i cili theksoi se e vetmja rrugë që nuk është shtruar, andaj kërkoj që kjo rrugë brenda këtij viti të shtrohet. Pastaj, pyeti tek rruga me katër korsi në qytet se ku janë kubat që po hiqen.

Ramiz Qeriqi: e paraqiti kërkesën e fshatit Krojmir, që rruga e cila është ndërtuar te shkolla, uji sipërfaqësor hynë nga rruga në oborrin e shkollës dhe pyeti se si ka mund të pranohet teknikisht ajo rrugë .

Burbuqe Ilazi: ngriti problemin se në disa rrugë në Lipjan janë vjedh kapakët e pusetave dhe po paraqesin rrezik për qytetarët, andaj kërkoi nga Drejtoria e Shërbimeve Publike që të intervenon në rregullimin e tyre e që është kërkesë edhe e qytetarëve të Lipjanit.

Arben Bahtiri: kërkoi që të ndërmerret diçka për zgjidhjen e problemit për qenët endacak si dhe çështjen e legalizimit të objekteve që të bëjë një njoftim Drejtoria e DPU-se deri se ku ka arrit ky proces dhe kërkoi që në qdo stacion të autobusëve të vihet itinerari i autobusëve.

Petrit Kelmendi, paraqiti shqetësimin e lagjes së Troshupëve e cila gjendet në mes të Lipjanit dhe Rufcit të Ri ku kërkoi zhavorrimin e kësaj rruge që lidhet me rrugën e transitit si dhe ndërtimin e urës te Lumi Janjevës.

Nehat Tërpeza: paraqiti shqetësimin e qytetarëve të fshatit Zllakuqan ku kërkoi zhavorrimin e rrugës së fshatit deri te shkolla dhe zhavorrimin e rrugëve në fshatin Ribar i Madh të cilat kanë mbetur pa asfaltuar.

Zoran Çirkoviq, kërkoi asfaltimin e rrugës te shkolla fillore “Braça Aksiq” e cila është një gjatësi vetëm 100 metra dhe kërkoi që mundësisht kjo rrugë të asfaltohet në këtë vit apo vitin e ardhshëm. Kërkesa e dytë ishte për fshatin Grackë e Vjetër ku objekti i ish Kooperativës bujqësore është blerë nga një person dhe i ka dhënë dikujt tjetër në shfrytëzim dhe aty është duke u punuar diçka, por askush nuk e di se çka punohet, andaj kërkoi që të formohet një komision dhe të shikon se çka është duke u punuar aty.


Naim Jahiri, kërkoi që te lagjja e muhaxhirëve në Smallushë të zhavorrohet rruga,

AMANDAMENTIMI I LIGJISLACIONIT

Rreth amandamentimit të rregulloreve të ndryshme të kuvendit komunal gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka pasur .


MUNGESA NË SEANCA

Në Kuvendin e Komunës së Lipjanit në pesë seancat e mbajtura në periudhën Qershor- Nëntor 2015 kemi mungesë të deputeteve në një seanca tre deputet.



PROPOZIM PËR REND DITE

Është shumë interesante që krahasim me periudhat e kaluara, kësaj radhe kemi vetëm dy propozime konkrete për rende dite nga përfaqësueses nga Lëvizja Vetëvendosje rreth çështjes së përfaqësimit të këtij subjekti politikë në Komitetin për Politikë dhe Financa dhe nga PDK-ja lidhur me çështjen e arsimit në Komunën e Lipjanit..



Burimet:

1. Intervista të drejtpërdrejta me qytetarë, pjesëtarë të shoqërisë civile dhe media lokale. Qershor - Nëntor 2015,.
2. Monitorimi i drejtpërdrejtë i aktiviteteve komunale nga zyrtaret e YAHR-it, Qershor - Nëntor 2015,.
3. Raportet mujore të drejtorive komunale të Komunës së Lipjanit, Qershor - Nëntor 2015,.
4. Komunikatat për media të YAHR-it Janar-Qershor 2015.
5. Ekstraktet nga mbledhjet e Kuvendit Komunal , Qershor - Nëntor 2015,
6. <http://kk.rks-gov.net/lipjan/> .

